

**VENDIM NR.1**  
**I ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË SBS Sh.p.k**

Sot më datë 19.01.2024, pranë selisë së shoqërisë **SBS sh.p.k**, shoqëri me përgjegjesi të kufizuar, e regjistruar në QKB, me NUIS L97019601M, më datë 19.08.2019 me seli, me adresë Korce, Bilisht, Rruga e Fshatit Tren KM.1.

Mbledhja u thirr dhe u drejtua nga Administratori i shoqërisë Edmond Zalla, prezent ortakët e shoqërisë:

- Z. Isuf Berberaj**, 1 kuotë që përfaqëson 30% të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Ilir Shtufi**, 1 kuotë që përfaqëson 34% të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Tomor Nallbati**, 1 kuotë që përfaqëson 36% të kapitalit të shoqërisë;

**Rendin e Ditës:**

- 1- Miratimi i pasqyrave financiare të shoqërisë për vitin 2023.
- 2- Miratimin e rezultatit Financiar, fitimi prej 26,307,161 leke.
- 3- Fitimi i periudhës në shumën 26,307,161 leke do të mbahet si rezerve për investime në periudhat në vijim.
- 4- Të ngarkohet Shoqëria Audituese "ALB BB Auditing" shpk Nipt:K31517001I themeluar me 18.03.2000 dhe rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit 25.02.2003, me Auditues Ligjor Lisjana Fusha, liçence profesionale Nr.326 datë 28.03.2014 të lëshuar nga Instituti Ekspertëve Kontabel të Autorizuar (IEKA) për vlersimin e kapitalit të shoqërisë deri më 31.12.2023.

Në përfundim të mbledhjes Ortakët e Shoqërisë pas diskutimit dhe shqyrtimit mbi çështjet në rendin e ditës morën njoftimin mbi pikën 1 të rendit të ditës e cila u morën në shqyrtim dhe në unanimitet:

**Vendosën:**

- 1- Miratimi i pasqyrave financiare të shoqërisë për vitin 2023.
- 2- Miratimin e rezultatit Financiar, fitimi prej 26,307,161 leke.
- 3- Fitimi i periudhës në shumën 26,307,161 leke do të mbahet si rezerve për investime në periudhat në vijim.
- 4- Të ngarkohet Shoqëria Audituese "ALB BB Auditing" shpk Nipt:K31517001I themeluar me 18.03.2000 dhe rregjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit 25.02.2003, me Auditues Ligjor Lisjana Fusha, liçence profesionale Nr.326 datë 28.03.2014 të lëshuar nga Instituti Ekspertëve Kontabel të Autorizuar (IEKA) për vlersimin e kapitalit të shoqërisë deri më 31.12.2023.

Ortakët e shoqërisë SBS sh.p.k

**Ilir Shtufi**  
**Nallbati**

**Isuf Berberaj**

**Tomor**

Prezent administratori  
Edmond Zalla

*Edmond Zalla*

*Isuf Berberaj*

*Tomor Nallbati*

Page 1 of 2

*Edmond Zalla*

**SBS** SUN  
BEAT  
SYSTEM  
Sh.p.k



**VENDIM NR.2**  
**I ASAMBLESE SË PËRGJITHSHME TË SHOQËRISË SBS Sh.p.k**

Sot më datë 30.01.2024, pranë selisë së shoqërisë **SBS sh.p.k**, shoqëri me përgjegjesi të kufizuar, e regjistruar në QKB, me NUIS L97019601M, më datë 19.08.2019 me seli, me adresë Korçe, Bilisht, Rruga e Fshatit Tren KM.1.

Mbledhja u thirr dhe u drejtua nga Administratori i shoqërisë Edmond Zalla, prezent ortaket e shoqërisë:

- Z. Isuf Berberaj**, 1 kuotë që përfaqëson 30% të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Ilir Shtufi**, 1 kuotë që përfaqëson 34% të kapitalit të shoqërisë;
- Z. Tomor Nallbati**, 1 kuotë që përfaqëson 36% të kapitalit të shoqërisë;

**Rendin e Ditës:**

- 1- Miratimin e lidhjes së Akt-marrëveshjes kuadër midis shoqërisë **NTSP sh.p.k**, shoqërisë **RTS shpk**, shoqërisë **SBS shpk**, **Z. Ilir Shtufi**, **Z. Isuf Berberaj** dhe **Z. Tomor Nallbati**.
- 2- Miratimin e Raportit të Shoqërisë Audituese ALB BB Auditing shpk Nipt:K31517001I themeluar me 18.03.2000 dhe rregjistruar në Qendren Kombëtare të Biznesit 25.02.2003, me Auditues Ligjor Lisjana Fusha, liçence profesionale Nr.326 date 28.03.2014 të leshuar nga Instituti Ekspertëve Kontabel të Autorizuar (IEKA) për vlersimin e kapitalit të shoqërisë deri më 31.12.2023.
- 3- Miratimin e kalimit të 34% të kuotave nga Z. Ilir Shtufi tek Z. Isuf Berberaj.
- 4- Autorizimin e administratorit të shoqërisë "SBS" shpk, Z. Edmond Zalla, që të nënshkruajë Akt-Marrëveshjen Kuadër.

Ortakët e paraqitur zotërojnë së bashku 100% të kapitalit të Shoqërisë.

Ne perfundim të mbledhjes, Ortaket e Shoqërisë pas diskutimit dhe shyrimit mbi çështjet në rendin e ditës dhe në unanimitet.

**Vendosën:**

- 1- Miratimin e lidhjes së Akt-marrëveshjes kuadër midis shoqërisë **NTSP sh.p.k**, shoqërisë **RTS shpk**, shoqërisë **SBS shpk**, **Z. Ilir Shtufi**, **Z. Isuf Berberaj** dhe **Z. Tomor Nallbati**.
- 2- Miratimin e Raportit të Shoqërisë Audituese ALB BB Auditing shpk Nipt:K31517001I themeluar me 18.03.2000 dhe rregjistruar në Qendren Kombëtare të Biznesit 25.02.2003, me Auditues Ligjor Lisjana Fusha, liçence profesionale Nr.326 date 28.03.2014 të leshuar nga Instituti Ekspertëve Kontabel të Autorizuar (IEKA) për vlersimin e kapitalit të shoqërisë deri më 31.12.2023.
- 3- Miratimin e kalimit të 36% të kuotave nga Z. Ilir Shtufi tek Z. Isuf Berberaj.




4- Autorizimin e administratorit të shoqërisë SBS" shpk, Z. Edmond Zalla, që të nënshkruajë Akt-Marrëveshjen Kuadër.




**Ilir Shtufi**  
**Nallbati**

Prezent administratori  
Edmond Zalla




**Ortakët e shoqërisë SBS sh.p.k**

**Isuf Berberaj**



**Tomor**





**KONTRATË SHKEMBIMI E KUOTAVE**  
**(Shoqëria "SBS" shpk)**

Sot, më date 30. 01.2024, u paraqit personalisht palet dhe rane dakort dhe nenshkruan aktin si vijon:

**PALËT KONTRAKTORE**

**Pala e Pare: Z.Illir Shtufi**, atësia Xhemal, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, i datelindjes 13.10.1973, madhor e me zotesi te polote juridike per te vepruar, i identifikuar me Karte identiteti Nr.H31013090C.

**Pala e Dyte: Z.Isuf Berberaj**, atësia Xhevit, lindur ne Reres, Pier dhe banues ne Rr. "Jakov Xoxa", Fier, i datelindjes 06.11.1952, madhor e me zotesi te polote juridike per te vepruar, i identifikuar me Karte identiteti Nr.F21106088B.

**Meqënëse:**

- Pala e Dyte dhe Pala e Pare jane ortakë në shoqërinë **SBS sh.p.k**, të ndarë në 2 kuota, të cilët zotërojnë respektivisht:
  - o **Z. Ilir Shtufi**, 1 kuotë që përfaqëson 34% të kapitalit të shoqërisë.
  - o **Z. Isuf Berberaj**, 1 kuotë që përfaqëson 30% të kapitalit të shoqërisë.
- Pala e Pare, dëshiron t'e shkembet me Palen e Dyte 34% të kuotës së tij ne Shoqërinë **SBS shpk**.
- Pala e Dyte, dëshiron të shkembet 34% të kuotës së Pales se Pare ne Shoqërinë **SBS shpk**.
- Asambleja e përgjithshme e shoqërisë **SBS sh.p.k** ka miratuar kalimin e 34% të kuotës së shoqërisë **SBS shpk** nga ortaku **Z.Illir Shtufi** tek **Z.Isuf Berberaj**.

**TANI E TUTJE Palët bien dakord përsa më poshtë vijon:**

**BAZA LIGJORE**

Në përputhje me nenet 750 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, ligjin Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".

Palët me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, bien dakord të hartojnë këtë Kontratë sipas kushteve në vijim:

**Neni 1**  
**Objekti i Kontratës**


- 1.1 Objekti i kësaj Kontrate, është transferimi nga pala, **Z.Illir Shtufi**, tek pala **Z.Isuf Berberaj**, i 34% (tridhjetë e kater përqind) të kuotës se kapitalit te shoqerise **SBS shpk**, me vlerë 49,806,876 Leke (dyzete e nente milion e teteqind e gjashte mije e teteqind e shtatedhete e gjashte) lekë, e cila përfaqëson 34% të kapitalit, që zotërohet nga pala **Z.Illir Shtufi** në shoqërinë **SBS sh.p.k**.

**Neni 2**  
**Çmimi dhe pagesa**

2.1 Çmimi i shkembimit të kuotës së zotëruar nga Pala e pare është 16,934,338 Leke (gjashtembjedhet milion e nenteqind e tridhjetë e kater mije e treqind tridhjetë e tete) lekë në total e cila është edhe vlera e këtij transaksioni.

Palët deklarojnë se nuk kanë pretendim për çmimin.

2.2 Çmimi i shkembimit dhe pageses së kuotës do te trajtohet midis paleve sipas mënyrës së përcaktuar në Akt-Marrëveshjen Kuader Nr.      Rep, Nr.      Kol, datë 30.01.2024. Palët deklarojnë se nuk kanë pretendim për mënyrën e pagesës pasi ajo është e përcaktuar ne Akt-Marrëveshjen Kuader Nr.      Rep, Nr.      Kol, datë 30.01.2024





**2.3** Pas nënshkrimit të kësaj Kontrate Pala e Dyte **Z.Isuf Berberaj** do të jetë zotërues i 64% të kuotave të kapitalit të shoqërisë **SBS sh.p.k.** Shoqëri do te kete ortak **Z.Isuf Berberaj** zoterues te 1 kuote me perqindje 64% dhe **Z.Tomor Nallbati** zoterues i 1 kuote me perqindje 36%.

### **Neni 3** **Transferimi i zotërimit të kuotave**

- 3.1** Pronësia e kuotave do të kalojë nga Pala e Pare tek Pala e Dyte menjëherë, me nënshkrimin e kësaj kontrate nga palët dhe kalimi i pronësisë do te regjistrohet në Qendrën Kombëtare të Biznesit Tiranë.
- 3.2** Pala e Pare dhe Pala e Dyte do të zbatojnë dhe dorëzojnë çdo instrument që mund të kërkohet për transferimin e kuotës dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe / ose në çdo autoritet ose institucion tjetër në përputhje me legjislacionin shqiptarë, për ta bërë të vlefshme.

### **Neni 4** **Zgjidhja e Mosmarrëveshjeve**

**4.1** Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë nga interpretimi ose zbatimi i kushteve të kësaj Kontrate, mes Palëve, do të zgjidhet me bisedime dhe mirëkuptim të ndërsjellë mes tyre. Në rast të kundërt, Palët do t'i drejtohen gjykatës kompetente.

### **Neni 5** **Kushtet e përgjithshme**

- 5.1** Kjo Kontratë përbën gjithë marrëveshjen plotë, dhe përfundimtare ndërmjet Palëve, në lidhje me çështjet në fjalë dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet dhe rëniet dakord paraprake, qoftë me gojë ose me shkrim, midis palëve pjesë e kësaj kontrate. Nuk ka asnjë lloj përfaqësimi, nxitje, premtime, deklarate të qëllimit ose marrëveshjeve, me gojë ose me shkrim, midis Palëve që nuk janë përmendur në këtë kontratë, të cilat kanë ndonjë forcë ose efekt, në lidhje me këtë Kontratë ose çështjet e saj.
- 5.2** Kjo Kontratë nuk do të ndryshohet, shfuqizohet ose anulohet, përveçse nga një instrument me shkrim i nënshkruar nga të dyja Palët dhe çdo instrument që pretendon të ndryshojë, zëvendësojë ose anulojë këtë Kontratë ose ndonjë pjesë të saj nuk do të jetë detyruese dhe nuk do të ketë efekt, përveç nëse dhe derisa të zbatohet dhe dorëzohet nga të dyja Palët.
- 5.3** Nëse njëra prej dispozitave të kësaj Kontrate është ose bëhet e pavlefshme ose e pazbatueshme, vlefshmëria ose zbatueshmëria e dispozitave të tjera nuk do të ndikohet. Dispozita e pavlefshme do të zëvendësohet me një marrëveshje të vlefshme ligjore që të jetë në përputhje sa më shumë që të jetë e mundur me qëllimet e palëve.
- 5.4** Kjo Kontratë do të drejtohet dhe interpretohet në përputhje me ligjet e Republikës së Shqipërisë. Kjo Marrëveshje bazohet, ndër të tjera, në nenet 705 dhe në vijim të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar, në nenet 73 dhe 74 të ligjit nr. 9901, në Ligjin Nr. 110, datë 20.12.2018 "Për Noterinë në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

### **Neni 6** **Njoftimet**

**6.1** Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi ndërmjet Palëve do të bëhet me shkrim me anë të postës rekomande në adresat e përcaktuara më poshtë dhe me anë të postës elektronike në adresat e mëposhtme:

**Për Palen e Pare:**

Email: [ishtufi@yahoo.com](mailto:ishtufi@yahoo.com)

**Për Palen e Dyte:**

E-mail:



**Neni 7**  
**Shtojcat e kontratës**

- 7.1** Kësaj Kontrate i bashkëngjiten dhe janë pjesë përbërëse e saj:
- Ekstrakti mbi të dhënat e regjistrimit të shoqërisë **SBS** sh.p.k.
  - Vendimi i Asamblesë së shoqërisë **SBS** sh.p.k
  - Akt Marreveshje Kuader
  - Kopje e dokumentit identifikues të Pales se pare **Z.Illir Shtufi**.
  - Kopje e dokumentit identifikues të Pales se Dyte **Z.Isuf Berberaj**.

**Neni 8**  
**Hyrja në fuqi**

- 8.1** Detyrimet dhe të drejtat që burojnë nga kjo Kontratë fillojnë efektet e tyre nga momenti i nënshkrimit të saj.
- 8.2** Kjo Kontratë përpilohet në 2 (dy) kopje të barazvlefshme. Çdo njëra prej tyre ka përmbajtje të njëjtë ligjore dhe secila Palë do të mbajë një kopje. Një kopje do të depozitohet për regjistrim në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Të gjitha dokumentet që duhen siguruar ose komunikimet që do të jepen ose bëhen sipas kësaj Kontrate do të jenë në gjuhën shqipe.

**PALËT KONTRAKTORE**


**PALA E PARE**

**Z. Ilir Shtufi**



**PALA E DYTE**

**Z. Isuf Berberaj**





## AKT- MARRËVESHJE KUADËR

Sot në Tiranë më datë 30 Janar 2024 (dymijë e njëzet e katër), ditën e \_\_\_\_\_, u paraqiten personalisht palet dhe nënshkruan kete AKT-Marveshje Kuader:

**PALA E PARË: Z.Illir Shtufi**, atësia Xhemal, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, i datelindjes 13.10.1973, madhor e me zotesi te polote juridike per te vepruar, i identifikuar me Karte identiteti Nr.H31013090C.

**PALA E DYTË: Z.Isuf Berberaj**, atësia Xhevit, lindur ne Reres, Fier dhe banues ne Rr. "Jakov Xoxa", Fier, i datelindjes 06.11.1952, madhor e me zotesi te polote juridike per te vepruar, i identifikuar me Karte identiteti Nr.F21106088B.

**PALA E TRETË: Z.Tomor Nallbati**, atësia Hajredin, lindur ne Bilisht, Devoll dhe banues ne Bilisht, Devoll, i datelindjes 19.08.1956, madhor e me zotesi te polote juridike per te vepruar, i identifikuar me Karte identiteti Nr.F60819040U

**PALA E T KATËRT: Shoqëria "NTSP" sh.p.k.**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L86326601H, më datë 26.01.2018 me seli, Rruga e Fshatit Tren Km.1, Parku Fotovoltaik, Korce, Bilisht, përfaqësuar nga Administratori **Z. Edmond Zalla**, atësia Gani, shtetas Shqiptare, lindur më 12.07.1977, lindur dhe banuese në Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim Nr.Personal H70712130H.

**PALA E PESTË: Shoqëria "RTS" Sh.p.k.**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L76812601U, më datë 12.06.2017 me seli, me adresë Fshatit Tren Km.1, Parku Fotovoltaik, Korce, Bilisht, Devoll, përfaqësuar nga Administratori **Z. Edmond Zalla**, atësia Gani, shtetas Shqiptare, lindur më 12.07.1977, lindur dhe banuese në Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim Nr.Personal H70712130H.

**PALA E GJASHTË: Shoqëria "SUN BEAT SYSTEM " Sh.p.k.**, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra Kombëtare e Biznesit) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS L97019601M, më datë 19.08.2019 me seli, me adresë Fshatit Tren Km.1, Parku Fotovoltaik, Korce, Bilisht, Devoll, përfaqësuar nga Administratori **Z. Edmond Zalla**, atësia Gani, shtetas Shqiptare, lindur më 12.07.1977, lindur dhe banuese në Tirane, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim Nr.Personal H70712130H.

**Të gjithë për efekt të kësaj kontrate do të cilësohen si "PALËT".**

### **BAZA LIGJORE**

-Neni 659 e vijues të Kodit Civil

-Ligji nr. 9901, datë 14.08.2009 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar



## KUSHTE PARAPRAKE

- Z. Ilir Shtufi dhe Z. Isuf Berberaj** janë ortakë të shoqërisë **NTSP sh.p.k** me NUIS L86326601H me kapital 25,000,000 Lek të ndarë në 2 kuota, të cilat i zotërojnë respektivisht:
  - **Z. Ilir Shtufi**, 1 kuotë që përfaqëson 70% të kapitalit të shoqërisë;
  - **Z. Isuf Berberaj**, 1 kuotë që përfaqëson 30% të kapitalit të shoqërisë.
- Z. Ilir Shtufi dhe Z. Isuf Berberaj** janë ortakë të shoqërisë **RTS sh.p.k** me NUIS L76812601U me kapital 100,000 Lek të ndarë në 2 kuota, të cilat i zotërojnë respektivisht:
  - **Z. Ilir Shtufi**, 1 kuotë që përfaqëson 70% të kapitalit të shoqërisë;
  - **Z. Isuf Berberaj**, 1 kuotë që përfaqëson 30% të kapitalit të shoqërisë.
- Z. Ilir Shtufi , Z. Isuf Berberaj dhe Z.Tomor Nallbati** janë ortakë të shoqërisë **SUN BEAT SYSTEM sh.p.k** me NUIS L97019601M me kapital 30,000,000 Lek të ndarë në 3 kuota, të cilat i zotërojnë respektivisht:
  - **Z. Ilir Shtufi**, 1 kuotë që përfaqëson 34% të kapitalit të shoqërisë;
  - **Z. Isuf Berberaj**, 1 kuotë që përfaqëson 30% të kapitalit të shoqërisë.
  - **Z.Tomor Nallbati**, 1 kuotë që përfaqëson 36% të kapitalit të shoqërisë.
- Z. Isuf Berberaj** dëshiron të largohet si ortak i dy shoqërive **NTSP sh.p.k** e **RT S sh.p.k** dhe **Z. Ilir Shtufi** dëshiron të zotërojë kuotën që **Z. Isuf Berberaj** zotëron në shoqërinë **NTSP sh.p.k.** dhe në shoqërinë **RT S sh.p.k** duke u bere zoteruesi i plote dhe i vetem i shoqërive **NTSP shpk** dhe **RT S sh.p.k.** Ne shkëmbim **Z. Isuf Berberaj** do përfitoje shtese te kuotave ne shoqerine **SUN BEAT SYSTEM sh.p.k.**
- Z. Ilir Shtufi** dëshiron të largohet si ortak i shoqërisë **SUN BEAT SYSTEM sh.p.k** dhe **Z. Isuf Berberaj** dëshiron të zotërojë kuotën që **Z. Ilir Shtufi** zotëron në shoqërinë **SUN BEAT SYSTEM sh.p.k.** duke u bere zoteruesi edhe te kuotes se **Z. Ilir Shtufi** ne shoqërinë **SUN BEAT SYSTEM shpk** . Ne shkëmbim **Z. Ilir Shtufi** do përfitoje shtesë të kuotave në dy shoqërite **NTSP sh.p.k** e **RT S sh.p.k** duke u bere zoteruesi i plote dhe i vetem i shoqërive.
- Palët bien dakort që qëllimi final i kësaj akt marrëveshje kuadër është që **Z. Ilir Shtufi** të zotërojë 100% të kapitalit të shoqërisë **NTSP shpk** dhe 100% të kuotave të shoqërisë **RT S shpk** dhe **Z. Isuf Berberaj** në këmbim të përfitojë shtim kuotash në shoqerine **SUN BEAT SYSTEM Shpk** në masën 34%.
- Z. Tomor Nallbati** dëshiron të qëndrojë në të njëjtat kushte që ka aktualisht ne shoqerine **SUN BEAT SYSTEM** pa patur asnje pretendim.

Në kuadër të kushteve paraprake të mësipërme Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Akt-Marrëveshje, këtu e me poshtë referuar si "Akt-Marrëveshje/a" ose "Kontratë/a", sipas kushteve të mëposhtme:



**NENI 1**  
**OBJEKTI I AKT MARRËVESHJES KUADËR**

- 1.1 Kjo kontratë ka për objekt rregullimin e marrëdhënieve midis Palëve dhe përcaktimin e kushteve dhe kuadrit të përgjithshëm për kalimin e shoqërisë NTSP shpk dhe R T S shpk ne pronesi 100% te Z. Ilir Shtufi në këmbim të të cilës palët gjithashtu bien dakort se Z.Isuf Berberaj do ti shtohet 34% me shume te kuota e tij ne shoqerine SUN BEAT SYSTEM shpk.
- 1.2 Ne perfundim te kesaj marrveshje kompanite NTSP shpk dhe R T S shpk do kene ortak te vetem Z. Ilir Shtufi me 100% tek secila shoqeri ndersa ne shoqerise SUN BEAT SYSTEM Shpk ortaket do jene Z. Isuf Berberaj me nje kuotë e perfaqeson 64% të kapitalit dhe Z. **Tomor Nallbati** me nje kuotë e cila perfaqeson 36% të kapitalit te shoqerise (sipas kontratave te kalimit te kuotave)
- 1.3 Për të realizuar këtë palët bien dakord se

**-Pjeset e Kuotave do të shkënbehën midis palëve të cituara në këtë kontratë duke ju referuar raportit të ekspertit kontabël në vlerësimin vlerës kapitale të shoqërive datë Janar 2024.**

**NENI 2**  
**KUSHTET SPECIFIKE**

- 2.1 Palët bien dakord se ortaku Z. **Ilir Shtufi** do përfitojë 100% të kuotave të shoqërisë **NTSP Shpk** dhe **RTS Shpk** nëpërmjet shkëmbimit me një pjesë kuote që ai zotëron në shoqërinë **SUN BEAT SYSTEM sh.p.k** dhe që përfaqëson 34% të kapitalit të saj.
- 2.2 Nga ana tjetër ortaku **Z.Isuf Berberaj** pranon të përfitojë 34 % më shumë pjesë kuote në shoqërinë **SUN BEAT SYSTEM shpk** në shkëmbim të heqjes dorë nga kuota që ai zotëron në shoqërintë **NTSP shpk** dhe **RTS shpk**.
- 2.3 Palët bien dakord se për të përcaktuar cmimin e shkëmbimit do të referohen raportit të ekspertit për vlerësimin kapital të seciles shoqeri, ku kushtet dhe kuadri i përgjithshëm për kalimin e shoqërisë NTSP shpk dhe R T S shpk ne pronesi 100% te Z. Ilir Shtufi do te jete në këmbim të shtimit të 34% me shume te kuotes tek Z.Isuf Berberaj ne shoqerine SUN BEAT SYSTEM shpk dhe do te kete kalim edhe te shumes 2,182,469 leke nga Z.Ilir Shtufi tek Z.Isuf Berberaj, pra shlyerja e ndërsjelltë e çmimit të shkëmbimit te kuotave, do të realizohet përmes kompensimit ne kuota dhe kalimit te shumes 2,182,469 leke nga Z.Ilir Shtufi tek Z.Isuf Berberaj.
- 2.4 Palët bien dakort që vlera mes 34% shtesë në vlerën kapitale të shoqërisë **SUN BEAT SYSTEM shpk** dhe vlera totale e 30% të vlerës kapitale të shoqërisë **NTSP shpk** dhe 30% të vlerës kapitale të shoqërisë **R T S shpk** nuk janë të barabarta, prandaj Z.Ilir Shtufi duhet të kalojë tek Z.Isuf Berberaj vlerën 2,182,469 leke shtese.
- 2.5 Si ortakë i shoqërisë **SUN BEAT SYSTEM shpk**, Z. **Tomor Nallbati** është dakort dhe nuk ka asnjë pretendim që kuota e Z.Ilir Shtufi ti kalojë Z.Isuf Berberaj dhe Z. Isuf Berberaj nga nje kuote ne 30% te kapitalit te behet zoterues i nje kuote me 64% te kapitalit dhe Z. Tomor Nallbati te qendroj ne nje kuote me 36% te kapitalit.





**NENI 3  
KONFIDENCIALITETI**

- 3.1 Secila palë do të trajtojë si konfidenciale dispozitat e kësaj Marrëveshjeje dhe dokumenteve të tjera që mund të prodhohen në zbatim të saj.

**NENI 4  
NDRYSHIMET DHE SHITESAT**

- 4.1 Gjatë kohëzgjatjes së kësaj Akt-Marrëveshje/Kontrate palët mund të bëjnë ndryshime të nevojshme në Akt-Marrëveshje vetëm me marrëveshje dhe miratim me shkrim të të gjitha palëve.

**NENI 5  
TËRËSIA DHE PAVLEFSHMËRIA E KONTRATËS**

- 5.1 Kjo Kontratë do të interpretohet duke marrë në konsideratë afatet dhe kushtet e saj në tërësi. Në çdo rast, nene apo formulime të paqarta do të shihen në kontekstin e të gjithë kontratës dhe në bazë të qëllimeve që bënë të nevojshme lidhjen e saj dhe ky interpretim do të bëhet pjesë e kësaj kontrate.
- 5.2 Nëse ndonjë nga dispozitat e kësaj kontrate bëhet e pavlefshme, e paligjshme apo e pazbatueshme, kjo dispozitë do të injorohet pa cënuar dispozitat e tjera të kësaj kontrate, të cilat qëndrojnë në fuqi me efekt të plotë ligjor. Asnjë dispozitë e kësaj kontrate nuk do të varet nga dispozita të tjera, përveçse kur në këtë kontratë përcaktohet ndryshe.

**NENI 6  
TË DREJTAT DHE DETYRIMET E PALËVE**

- 6.1 Palët deklarojnë se njohin dhe janë në dijeni të bazës ligjore të kësaj Akt-Marrëveshjeje, se i njohin dhe i pranojnë pa asnjë rezervë, detyrimet që do rrjedhin prej tyre.

**NENI 7  
NJOFTIMET**

- 7.1 Çdo njoftim, kërkesë apo çdo lloj komunikimi ndërmjet Palëve do të bëhet me shkrim me anë të postës rekomandë me lajmërim marrje në adresat e përcaktuara më poshtë dhe me anë të postës elektronike në adresat e mëposhtme:

Për Z. Ilir Shtufi:

E-mail: [ishtufi@yahoo.com](mailto:ishtufi@yahoo.com)





**Për Z. Isuf Berberaj:**

Email:

**Për Z. Tomor Nallbati:**

E-mail:

**Për NTSP Sh.p.k:**

E-mail: finance@novasolar.com.al

**Për RTS Sh.p.k:**

Email: finance@novasolar.com.al

**Për SUN BEAT SYSTEM Sh.p.k:**

Email: finance@novasolar.com.al

## **NENI 8 ZGJIDHJA E MOSMARRËVESHJEVE**

- 8.1** Palët bien dakord të respektojnë detyrimet e marra përsipër me anë të kësaj Akt Marrëveshje. Në rast mosrespektimi të këtyre detyrimeve ato do t'u nënshtrohen sanksioneve të parashikuara në këtë Akt Marrëveshje dhe në legjislacionin shqiptar.
- 8.2** Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje, pretendim apo kundërshtim që lind nga, ose në lidhje me këtë Akt-Marrëveshje, çdo shkelle, ndërprerje, detyrim, interpretim në lidhje me vlefshmërinë, duke përfshirë përcaktimin, qëllimin dhe aplikueshmërinë e kësaj Akt-Marrëveshje, por jo vetëm këto, ta zgjidhin me mirëkuptim. Nëse nuk realizohet zgjidhja me mirëkuptim, palët mund t'i drejtohen gjykatës kompetente për zgjidhjen e saj.

## **NENI 9 DISPOZITA TË FUNDIT**

- 9.1** Kjo Kontratë përbën tërësinë e mirëkuptimit dhe marrëveshjes së Palëve dhe bën të pavlefshme çdo marrëveshje me shkrim ose me gojë, të mëparshme të Palëve.
- 9.2** Pas nënshkrimit dhe përmbushjes së kësaj marrëveshje apo dhe të kontratave të cituara në pikën 1.2 të nenit 1, palët deklarojnë që nuk kanë asnjë pretendim financiar, ligjor, ose të çdo lloj forme tjetër, të kaluar ose të ardhshëm kundrejt njëri tjetrit si individë apo nëpërmjet shoqërive ku janë pjestare.
- 9.3** Kjo kontratë është nënshkruar në 7 kopje me vlerë të njëjtë ligjore dhe secila Palë mban nga një kopje.
- 9.4** Kjo kontratë hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të saj nga Palët.



**NENI 10**  
**DOKUMENTAT QË I BASHKËNGJITEN AKT MARRËVESHJES**

- 10.** Kësaj Akt- Marrëveshje i bashkohen dhe janë pjesë integrale e saj dokumentet e mëposhtme:
- i. Vendimi i asamblese të shoqërive të cilat janë palë në këtë Akt-Marrëveshje.
  - ii. Raporti i ekspertit kontabël për vlerësimin e kapitalit për secilën nga shoqëritë
  - iii. Kontratat e kalimit të kuotave për secilën nga shoqëritë
  - iv. Ekstraktet e shoqërive të cilat janë palë në këtë Akt-Marrëveshje.
  - v. Dokumentat e identifikimit të palëve.

Të gjitha dokumentet që duhen siguruar ose komunikimet që do të jepen ose bëhen sipas kësaj Kontrate do të jenë në gjuhën shqipe.

**PALËT NË AKT-MARRËVESHJE**

Z. Ilir Shtufi

*Ilir Shtufi*

Z. Isuf Berberaj

*Isuf Berberaj*



Z. Tomor Nallbati

*Tomor Nallbati*

**Shoqëria NTSP shpk**

*Përfaqësuar nga administratorët*

**Z. Edmond Zalla**

*Edmond Zalla*  

**Shoqëria RTS shpk**

*Përfaqësuar nga administratori*



**Z. Edmond Zalla**

*Edmond Zalla*  

**Shoqëria SUN BEAT SYSTEM shpk**


*Përfaqësuar nga administratori*

**Z. Edmond Zalla**

*Edmond Zalla*  



# Njoftim Debitimi / Debit Advice



Raiffeisen Bank Albania / Swift: SGSBALTX

Dega / Branch 001

Data / Date 31/01/2024

Midas Reference / Midas Reference Number P240131ACMZOP14

Luka Reference / Luka Reference Number 20240131VAELTA.DIKO00137945

Klienti Urdhërues / Ordering Customer ILIR XHEMAL SHTUFI (Oct 13 1973 )

RR KAJO KARAFILI BANESE PRIVATE

Numri i llogarise / Account Number 4300453660

IBAN AL28202110370000004300453660

Shuma e urdheruar 2,182,469.00

Monedha ALL

Kursi i kembimit 1.00000000

Detajet e pageses / Details of Payment KALIM PER BLERJEN E KUOTAVE SIPAS  
MARVESHJES KUADER DARE 30/01/2024

Komisione / Commissions 50.00

Klienti Perfitues / Beneficiary Customer ISUF XHEVIT BERBERAJ (Nov 6 1952 )

Numri i llogarise 0030562651

IBAN AL72202210120000000030562651

Date Valuta / Value Date 31/01/2024

## **Rifreskoni kontaktet tuaja! / Update your contacts!**

*Nëse ndryshoni kontaktet tuaja (numër telefoni, adresë), vizitoni degën Raiffeisen më të afërt për ti rifreskuar ato. Vetëm duke patur numër telefoni dhe adresën tuaj të saktë, ne mund t'ju njoftojmë për çdo ofertë, produkt ose shërbim bankar. / In case you will change your contacts (mobile number, address), visit any Raiffeisen Bank branches to update them. Your new contacts allow us to inform you in real time on new offers, products & services, and other.*





## Raporti i Audituesit te Pavarur

Une Lisjana Fusha Auditues Ligjor, jam emeruar nga Asambleja e Ortakeve te shoqerise "SUN BEAT SYSTEM" shpk per te kryer vleresimin kontabel te te shoqerise deri ne 31 Dhjetor 2023

Nga verifikimi i dokumentacionit baze rezulton se shoqeria "SUN BEAT SYSTEM" shpk eshte rregjistruar si person juridik prane Qendres Kombetare te Biznesit me date 19.08.2019, dhe NIPT-in L97019601M me ortaket:

- z. Ilir Shtufi 34% Kapitalit aksioner
- z. Isuf Berberaj 30% Kapitalit aksioner
- z. Tomor Nallbati 36% Kapitalit aksioner

Ne Pasqyrat Financiare te shoqerise te vitit 2022 rezultojne keto te dhena:

Nr	Emertimi	Shuma ne leke
1	Aktivet Afatshkurtera	15,727,745
2	Aktivet Afatgjata	158,520,602
3	Detyrimet Afatshkurtera	64,756,921
4	Detyrimet Afatgjata	85,991,710
5	Kapitali	23,499,715
	Nga ky	
	Kapitali Aksioner	30,000,000
	Humbja e mbartur	(1,760,271)
	Fitimi i vitit financiar	(4,740,014)

Mbi bazen e te dhenave te me sipërme del se aktivet e shoqerise me 31.12.2022 jane gjithsej 174,248,347 leke ndersa detyrimet ndaj te treteve jane 150,748,632 leke, pra kapitalet e veta te shoqerise mbeten 23,499,715 leke ku 30,000,000 perbejn zerin kapitali i nenshkruar, humbjet e mbartura 1,760,271 leke dhe humbja e vitit 4,740,014leke .





Por shoqeria per periudhen 01 janar deri me 31 dhjetor 2023 ka kryer aktivitet dhe ka ndryshime ne rezultatet e saja, te cilat ndikojn ne vleren e kapitalit, me keto te dhena:

- Sipas vendimit te ortakut per miratimin e Pasqyrave financiare depozituar prane Qendren Kombetare te Regjistrimit me date 24 Korrik 2023, humbja e vitit kalon ne humbje te mbartura.
- Gjithashtu pasqyra e pozicionit financiar dhe pasqyra e performances paraprake te shoqerise "SUN BEAT SYSTEM" shpk per periudhe 01.01.2023-31.12.2023 eshte:

Pasqyra e Pozicionit Financiare te shoqerise te vitit deri 31.12.2023 rezultojne keto te dhena:

Nr	Emertimi	Shuma ne leke
1	Aktivet Afatshkurtera	7,703,062
2	Aktivet Afatgjata	193,568,340
3	Detyrimet Afatshkurtera	76,090,100
4	Detyrimet Afatgjata	75,374,426
5	Kapitali	49,806,876
	Nga ky	
	Kapitali Aksioner	30,000,000
	Humbjet e mbartura	(6,500,285)
	Fitimi i vitit financiar	26,307,161

Pas analizez se faktoreve qe ndikojn ne vleren kapitale te shoqerise "SUN BEAT SYSTEM" shpk, vlera kapitale e shoqerise vleresohet deri ne periudhen 31.12.2023 rezulton te kete keto te dhena:

Pasqyra e performances te shoqerise te vitit deri 31.12.2023 rezultojne keto te dhena:

Nr	Emertimi	Shuma ne leke
1	Te ardhura nga aktiviteti kryesor	38,499,067
2	Shpenzimet e llogaritura	(8,676,756)
3	Amortizimi	(0)
4	Tatim fitimi i llogaritur	(3,515,150)
	Fitimi viti 2023	26,307,161

*Jeshe*



Si konkluzion perfundimtar :

**Vlera Kapitale e shoqerise** "SUN BEAT SYSTEM" shpk shkon ne 49,806,876 leke, ku 30,000,000leke Kapitali Aksioner, 6,500,285 leke humbje te mbartura dhe 26,307,161leke fitimi 2023.

Vlera Kapitale e shoqerise vleresohet nga

Ortaku	Kuota	%	Leke
Illir Shtufi	1	34	7,989,903
Isuf Berberaj	1	30	7,049,915
Tomor Nallbati	1	36	8,459,897

ne

Ortaku	Kuota	%	Leke
Illir Shtufi	1	34	16,934,338
Isuf Berberaj	1	30	14,942,063
Tomor Nallbati	1	36	17,930,475

LISJANA FUSHA  
*Auditues Ligjor*

*Lisjana Fusha*  
*Fusha*

Date 22 Janar 2024

Blv : "Bajram Curri", Pallatet 1 Maji, H. 6,  
kati 2, Ap.55, Njësia bashkiake Nr 5,  
Tiranë-Albania  
Tel: Mob. 0694011022  
lisjana.fusha@albbbauditing.com

